

I. HYRJE

Në këtë politikë përshkruhet mënyra e mbikëqyrjes me kamera vëzhgimi CCTV në të gjitha ambientet që ushtrohet veprimtaria e Bankës Credins në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale, përfshirë por pa u kufizuar si në vijim, (Zyrat Qëndrore, Degët, Agjencitë, ATM-të) etj.

Gjithashtu kjo politikë synon të përcaktojë masat teknike dhe organizative që do të aplikohen për të siguruar besueshmërinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale përmes kryerjes së përpunimit të të dhënave nëpërmjet kamerave të vëzhgimit, periudhën e ruajtjes së video regjistrimeve, mënyrë e fshirjes së tyre si dhe të drejtat e detyrimit e personave të autorizuar që kanë akses në sistemin e vëzhgimit me kamera.

II. BAZA LIGJORE

Kjo politikë është hartuar në bazë të:

- Ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”;
- Ligji nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale";
- Udhëzimit nr.46, datë 28.03.2017 “Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë në zbatim të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”;
- Udhëzim nr. 3 datë 30.04.2025 i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e videosurvejimit"
- Udhëzim nr. 20/2012 i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar”.

III. QËLLIMI I PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE NËPËRMJET KAMERAVE TË VËZHGIMIT

Në zbatim të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” si dhe në mbështetje të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Banka Credins monitoron nëpërmjet kamerave të vëzhgimit ambientet e saj.

Vendosja e kamerave kryhet në mënyrë të tillë që të plotësojë qëllimin e politikave të Bankës Credins, për sigurimin e personelit, klientëve dhe të pronës së bankës nga një rrezik evident.

IV. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE NËPËRMJET KAMERAVE TË VËZHGIMIT

Banka garanton sistem të lartë sigurie për ruajtjen dhe përpunimin e mëtejshëm të të dhënave që përpunohen nëpërmjet vëzhgimit me kamera, në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Asnjë informacion që përpunohet nga sistemet e vëzhgimit me kamera nuk komunikohet ose shpërndahej përveç rasteve kur informacioni kërkohet nga organet kompetente që e fitojnë këtë të drejtë me ligj të veçantë duke respektuar kërkesat e ligjit.

Personat e autorizuar në Bankë për përpunimin dhe administrimin e të dhënave nëpërmjet sistemeve të kamerave të vëzhgimit mund të vënë në dispozicion materialet vizive apo të dhënat e tjera, që përfitohen nga përdorimi i masave shtesë të sigurisë, me kërkesë të Policisë së Shtetit ose organeve të drejtësisë, vetëm për nevoja hetimi, bazuar në Kodin e Procedurës Penale dhe në legjisllacionin në fuqi.

Punonjësit e Bankës i nënshtrohen detyrimit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit, i cili i jepet këtij të fundit për të ushtruar funksionet e tij në bazë të Ligjit, dhe mund t'ua përhapë atë vetëm autoriteteve kompetente në përputhje me nenin 13 të ligjit "Për masat shtesë të sigurisë publike". Banka vlerëson integritetin e punonjësve të saj përpara se ata të punësohen.

Banka monitoron pajtueshmërinë e punonjësve të saj mbi detyrimet e tyre në lidhje me sigurinë e informacionit që përpunojnë.

Pala përgjegjëse për trajtimin e të dhënave personale është "Banka CREDINS" Sh.a me seli qendrore në Rr. "Vaso Pasha", Nr. 8, Tiranë, Shqipëri.

V. KATEGORITË E SUBJEKTEVE TË TË DHËNAVE QË PËRPUNOHEN DHE RREGULLAT BAZË

Kamerat e vëzhgimit përpunojnë të dhënat e kategorive të ndryshme të subjekteve të të dhënave personale brenda bankës përfshirë por pa u kufizuar si në vijim, (Klientë/ Punëmarrës/ Furnitorë/ Vizitorë, etj).

Disa rregulla mbi vendosjen e kamerave në ambientet e bankës:

- Sistemi i kamerave nuk duhet të cenojë të drejtat themelore të individit duke ndërhyrë në jetën private të tij.
- Masat e sigurisë duhet të jenë të plota për mbrojtjen e të dhënave që përfitohen nga regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e këtyre të dhënave.
- Në hyrje të ambienteve të bankës, të cilat monitorohen me kamera vëzhgimi, vendosen tabela informuese për njoftimin e subjekteve të të dhënave mbi ekzistencën e një sistemi vrojtimi sipas aneksit nr. 2 ndërsa në vende që janë të instaluara kamera me regjistrim audio vendoset tabela informuese sipas aneksit nr.1.

- Kamerat nuk vendosen në hapësira të tilla si: tualete, dhoma zhveshje, brenda në dollapë apo ambiente të tjera të ngjashme.
- Në ambientet e punës së personelit mund të vendosen kamera vetëm për të vëzhguar për arsye sigurie.

VI. PËRDORIMI I SISTEMIT TË VËZHGIMIT ME KAMERA

- Monitorimi nëpërmjet pajisjeve të vrojtimit kryhet nga Drejtori Degës dhe nga Departamenti i Sigurisë (Salla Qëndrore e Monitorimit) në Bankën Credins.
- Pajisja për regjistrimin e pamjeve vendoset në një vend të sigurt në degë dhe në Sallën Qëndrore të Monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme të bankës.
- Pamjet e përfuara nga sistemi i kamerave dhe informacioni i regjistruar, kontrollohen vetëm nga specialisti për Sistemet e Sigurisë Elektronike (SSE), në Departamentin e Sigurisë.
- Në rastet kur kërkohet akses në të dhëna personale nga regjistrimi me kamera sa herë ka ankesa të lidhura me shërbimin e ATM-ve ose në sportele, bëhet kërkesë me shkrim nga subjekti i të dhënave, në të cilën paraqitet arsyeja dhe koha kur ka ndodhur ngjarja. Kjo kërkesë administrohet nga Drejtori i Degës/ Përgjegjësi i Agjencisë dhe Departamenti i Sigurisë, duke garantuar kështu të drejtën për akses dhe të drejtën e përpunimit të të dhënave nga banka.
- Nëse kemi të bëjmë me një kërkesë të përgjithshme, subjekti i të dhënave personale informohet mbi politikën e vëzhgimit me kamera e cila është e vendosur edhe ne web-in e Bankës për t'u informuar në zbatim të nenit 13 të ligjit nr.124/2024.
- Për kërkesat më specifike, personat përgjegjës në bankë që kanë akses në informacion i trajtojnë në mënyrë më të detajuar që përfshin dhënien e aksesit në imazhet ku subjekti i të dhënave shfaqet (të dhënat e tij personale) duke hequr imazhet e personave të tretë (e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale, e drejtë e cila çënohet nëse këto imazhe aksesohen nga një person i tretë i paautorizuar).
- Në raste të caktuara kur duhet të përhapen të dhënat, në bazë të nenit **13** të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shitesë të sigurisë publike”, materialet e përfuara nga kamerat e sigurisë u vihen në dispozicion institucioneve përkatëse, duke kryer veprime të shpejta nga Departamenti i Sigurisë për kthimin e përgjigjeve ndaj këtyre institucioneve.

- Personeli i Sistemeve të Sigurisë Elektronike që kanë dijeni për të dhënat e kontrolluara apo përpunuara, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.
- Kur sistemet e mbrojtjes pasive nuk punojnë, Drejtori i Degës/ Përgjegjësi i Agjencisë duhet të njoftojë menjëherë Specialistin për Sistemet e Sigurisë Elektronike nëpërmjet sistemeve të vëzhgimit me kamera, për riparimin e defektit dhe për të shtuar masat mbrojtëse. Njoftimi dhe gjendja e defektit për mosfunksionimin e sistemit të kamerave apo alarmeve, deri në riparimin e tyre, duhet të mbahet sekret edhe për personelin e njësisë së bankës. Afati maksimal për zgjidhjen e problematikave është 3 (tre) ditë nga dita e njoftimit.
- Specialisti për Sistemet e Sigurisë Elektronike/ Drejtori i Departamentit të Sigurisë, në rast kompromentimi, manipulimi ose modifikimi të paautorizuar të sistemeve të sigurisë që mund të çenojnë të dhënat personale, duhet të njoftojë menjëherë Departamentin e Sigurisë së Informacionit dhe Vazhdimësisë së Biznesit dhe nëpunësin për mbrojtjen e të dhënave personale. Në vijim, nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale është përgjegjës për të informuar Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përputhje me nenin 13 të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

VII. ZONAT QË MBULOHEN NGA SISTEMI I VËZHGIMIT ME KAMERA

Në objektet e ushtrimit të veprimtarisë së Bankës Credins monitorohen me kamera vëzhgimi në mënyrë të pandërprerë:

- Sipërfaqet e jashtme të fasadës së bankës;
- Hyrja për në ambientin e brendshëm/ koridore/ salla mbledhësh;
- Zona e klientit, sporteli dhe zona e arkëtareve;
- Zona e ruajtjes dhe e administrimit të vlerave monetare (hyrja dhe ambienti i brendshëm);
- Zona e ruajtjes dhe e administrimit të dokumentacionit (hyrja dhe ambienti i brendshëm);
- Zona ku vendosen sistemet e teknologjisë së informacionit (hyrja dhe ambienti i brendshëm);
- Zona përreth gjeneratorëve;
- Ambienti përreth ATM-ve;
- Parkingu;
- Rruga e shoqërimit të mjeteve monetare (rruga e cash-it).

VIII. AFATET E RUAJTJES TË TË DHËNAVE PERSONALE

Të dhënat personale të subjekteve përpunohen në sistemet e vëzhgimit me kamera CCTV në përputhje të plotë me masat e sigurisë të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Informacioni që regjistrohet në DVR, është sekret. Ky informacion ruhet për një afat nga **30 (tridhjetë) – 60 (gjashtëdhjetë)** ditë.

Banka mbron të dhënat në ambiente dhe sisteme të sigurta deri në përfundimin e afatit të përcaktuar, më pas të dhënat fshihen automatikisht nga sistemi i vëzhgimit.

IX. AKSESI NË TË DHËNAT PERSONALE

Banka CREDINS përpiqet të jetë sa më e hapur për t'i dhënë individëve akses në të dhënat e tyre personale. Subjektet e të dhënave personale mund të informohen nëse ne mbajmë të dhëna personale të përfituar nga sistemet e vëzhgimit me kamera, duke na dërguar një "kërkesë për akses tek të dhënat personale" dhe në bazë të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", banka ju informon brenda afatit ligjor (30 deri në 60 ditë) mbi të dhënat ose ju shpjegojmë arsyen e mosdhënies së informacionit.

Në këtë kuadër, në përmbushje të detyrimit ligjor që kemi, ne do t'ju:

- Bëjmë me dije se përse i mbajmë ato dhe ju informojmë nëse përpunimi i të dhënave personale është i detyrueshem apo vullnetar;
- Japim mundësinë subjektit të të dhënave që të konsultohet mbi përpunimin e të dhënave përkatëse vetëm në njësinë përgjegjëse që administron të dhënat tuaja.

Për çdo të dhënë personale që ne mund të mbajmë, si edhe mbi çdo të drejtë që në cilësinë e subjektit të të dhënave gëzoni në përputhje me ligjin nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" është e nevojshme të bëni një kërkesë pranë bankës duke dorëzuar dokumentet ligjore të identifikimit tuaj.

X. TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

Individët, të dhënat personale të të cilëve përpunohen, në bazë të Ligjit nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", kanë të drejtë të marrin në çdo kohë konfirmimin për ekzistencën ose jo të të dhënave personale dhe të dinë përmbajtjen dhe burimin e tyre, të verifikojnë saktësinë, përditësimin ose korrigjimin, të kërkojnë informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave personale të përpunuara, bllokimin e informacionit dhe të dhënave që trajtohen në kundërshtim me ligjin, të ankohen si dhe në çdo rast të kundërshtojnë, për arsye të ligjshme, trajtimin e tyre.

Banka ju informon për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, si edhe mbi çdo të drejtë që ju në cilësinë e subjektit të të dhënave gëzoni në përputhje me Ligjin Nr. 124/2024 " Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

1. **"E drejta për informim"**- duke garantuar që informacioni i kërkuar, të jepet në një formë koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, veçanërisht kur informacioni u drejtohet të miturve;
2. **"E drejta e aksesit"**- garantohet duke ofruar mundësinë që të marrë nga Banka një kategori më të gjerë informacioni, nëse të dhënat e tij personale janë duke u përpunuar;
3. **"E drejta për korrigjim dhe fshirje"**, - Subjekti i të dhënave ka të drejtën e korrigjimit nga kontrolluesi të të dhënave të pasakta personale që lidhen me të sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes së kërkesës.
4. **"E drejta për të kundërshtuar"**- Subjekti i të dhënave ka të drejtën të kundërshtojë në çdo kohë për arsye që lidhen me situatën e tij të veçantë përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të.
5. **"E drejta për të mos iu nënshtruar vendimmarrjes automatike"** - Subjekti i të dhënave ka të drejtë të mos jetë subjekt i një vendimi që bazohet vetëm në përpunimin automatik të të dhënave, përfshirë profilizimin, i cili shkakton pasoja ligjore ose pasoja të ngjashme të rënda mbi të.
6. **"E drejta për të kufizuar përpunimin e të dhënave"** Subjekti i të dhënave ka të drejtë për kufizimin e përpunimit të të dhënave nga kontrolluesi (Banka) kur ekzistojnë shkaqet e percaktuara në nenin 17 dhe 21 të ligjit nr. 124/2024, duke specifikuar konkretisht arsyet e mundshme për "kufizimin" e përpunimit.
7. **"E drejta për t'u harruar"** Me kërkesën e subjektit të të dhënave, operatorët e motorëve të kërkimit në internet janë të detyruar të fshijnë nga rezultatet që shfaqen pas një kërkimi të kryer në bazë të emrit të subjektit të të dhënave, informacionin, i cili nuk është më aktual me kalimin e kohës, por që, kur gjendet, ka një ndikim negativ të konsiderueshëm në reputacionin e subjektit të të dhënave.
8. **"E drejta për transferueshmërinë e të dhënave"** synon t'i ofrojë mundësinë subjektit të të dhënave për të transferuar, kopjuar ose transmetuar lehtësisht të dhënat personale nga një kontrollues te një kontrollues tjetër për qëllime të caktuara, që lidhen me ofrimin/marrjen e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.
9. **"E drejta për t'u ankuar"** - Pavarësisht mjeteve të tjera ligjore në dispozicion, administrative ose gjyqësore, çdo subject i të dhënave që pretendon se përpunimi i të dhënave të tij personale kryhet në shkelje të ligjit nr.124/2024, ka të drejtë të paraqesë ankim pranë Komisionerit, i cili e shqyrton atë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative dhe ligjit nr.124/2024.

Kufizimet e të drejtave të subjekteve të të dhënave

Fusha e zbatimit të të drejtave të parashikuara në nenet 13–20 të ligjit nr. 124/2024 dhe të detyrimeve që burojnë për kontrolluesin (Bankën), si dhe neni 6 “Parimet për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale” i ligjit nr.124/2024, për aq sa dispozitat e tij lidhen me të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në nenet 13–20 të këtij ligji, **mund të kufizohen me ligj.**

Kufizimi duhet të respektojë thelbin e të drejtave dhe të lirive themelore e të jetë i nevojshëm e proporcional në një shoqëri demokratike për të garantuar sigurinë kombëtare, sigurinë publike ose interesat ekonomike të vendit, për parandalimin e trazirave ose të veprave penale, ose për mbrojtjen e të drejtave e të lirisë së personave të tjerë.

XI. SI TË NA KONTAKTONI

Kërkesat për informacion në lidhje me politikën tonë të privatësisë dhe çështjet për mbrojtjen e të dhënave personale mund të dërgohen me e-mail në adresën info@bankacredins.com, pranë nëpunësit për mbrojtjen të dhënave personale në adresën dpo@bankacredins.com ose nëpërmjet shkresës në adresën e selisë qendrore si edhe të paraqiteni pranë sporteleve të Bankës “CREDINS” Sh.a.

Kur ka dyshime të arsyeshme në lidhje me identitetin e personit, i cili paraqet kërkesë sipas neneve 13–20 të ligjit nr.124/2024, Banka i kërkon informacion shtesë, me qëllim verifikimin e identitetit të subjektit të të dhënave.

Përgjigja ndaj kërkesës së një subjekti të të dhënave, sipas neneve 13–20 të ligjit nr.124/2024, ofrohet falas. Megjithatë kur kërkesat nga një subjekt i të dhënave janë qartazi të pabazuara ose të tepruara, sidomos për shkak të karakterit të tyre të përsëritur, Banka mund:

- a) të vendosë një tarifë të arsyeshme, duke marrë parasysh kostot administrative për ofrimin e informacionit ose të komunikimit, ose për të ndërmarrë veprimin e kërkuar; ose
- b) të refuzojë ndërmarrjen e veprimeve për kërkesën.

XII. DISPOZITA TE FUNDIT

Në rast keqpërdorimi apo cënimit të privatësisë nëpërmjet sistemeve të vëzhgimit me kamera, subjektet e të dhënave kanë të drejtë të ankohen pranë:

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në adresat e mëposhtme:

Nr. Gjellbër 0800 20 50 / www.idp.al / info@idp.

ANEKSI 1: Zonë e mbikëqyrur me kamera dhe audio

ZONË E MBIKËQYRUR ME KAMERA DHE AUDIO



Qëllimi i përpunimit të imazheve tuaja është për të parandaluar cënimin dhe për të garantuar sigurinë e individit, pronës dhe sigurinë publike.

Subjektet e të dhënave personale, mund të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas ligjit nr.124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" pranë:

"CREDINS Bank" sh.a

(Emri i kontrolluesit)

Subjekt i ligjit nr. 19/2016 "Për masat shitesë të sigurisë publike"

Tel: 04 53 53 000 E-mail: info@bankacredins.com

(Kontakti)

Nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të kontaktohet përmes e-mail: dpo@bankacredins.com.

Në rast keqpërdorimi të të dhënave personale apo cënim të privatësisë nëpërmjet sistemit të kamerave, subjektet kanë të drejtën të ankohen pranë:

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Të dhënat tuaja nuk përpunohen për një afat më të gjatë se sa është e nevojshme për përpunimin dhe mbahen me masa sigurie me akses të kufizuar personeli të autorizuar.

Nr. i Gjellbër: 0800 20 50

www.idp.al info@idp.al

ANEKSI 2: Zonë e mbikëqyrur me kamera

ZONË E MBIKËQYRUR ME KAMERA



Qëllimi i përpunimit të imazheve tuaja është për të parandaluar cënimin dhe për të garantuar sigurinë e individit, pronës dhe sigurinë publike.

Subjektet e të dhënave personale, mund të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas ligjit nr.124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" pranë:

“CREDINS Bank” sh.a

(Emri i kontrolluesit)

Subjekt i ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”

Tel: 04 53 53 000 E-mail: info@bankacredins.com

(Kontakti)

Nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të kontaktohet përmes e-mail: dpo@bankacredins.com.

Në rast keqpërdorimi të të dhënave personale apo cënim të privatësisë nëpërmjet sistemit të kamerave, subjektet kanë të drejtën të ankohen pranë:

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Të dhënat tuaja nuk përpunohen për një afat më të gjatë se sa është e nevojshme për përpunimin dhe mbahen me masa sigurie me akses të kufizuar personeli të autorizuar.

Nr. i Gjelbër: 0800 20 50

www.idp.al info@idp.al